

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Unit	Nr. Prot. Broj Prot.
01/B	1561
Nr. i faqeve Br. stranica	Data: Datum:
2	16.08.2021
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit*  
- *Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije -- Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

**Kabineti i Ministres /Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister**

Numër: 01B/248  
Datë: 16.08.2021

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në mbështetje të Rregullores (QRK) - nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e datës 30.03.2021, nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, shtojcës 1 paragrafi 7 dhe pikës 4.2 të Vendimit me Nr. 13-19 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 14.04.2021, nxjerrë këtë:

### **THIRRJE**

**Për mbështetje financiare të studenteve vajza/gra në fushat e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës (apo STEM) të arsimit të lartë në Kosovë**

Thirrja synon ta mbështesë shkollimin e vajzave/grave që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë në programet e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës (apo STEM në gjuhën angleze). Të drejtë aplikimi kanë studentet që në vitin akademik 2021-2022 regjistrojnë vitin e parë të studimeve në këto fusha në nivelin baçelor dhe që këto studime i vijnë si studente të rregullta.

Me këtë thirrje do të mbështeten 1,000 studente të fushave STEM me bursa në vlerë prej 1,000 (njëmijë) EUR/vit.

## **PËRSHTATSHMËRIA E KANDIDATES PËR APLIKIM**

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha vajzat/gratë që regjistrohen në një nga programet e fushave STEM në Kosovë, sipas aneks-listës së programeve të publikuar me këtë thirrje. Përparësi kanë kandidatet që kanë sukses të shkëlqyer paraprak.

Kjo formë e mbështetjes financiare ka për qëllim të promovojë pjesëmarrjen e vajzave/grave në fushat STEM dhe merr në konsideratë gjendjen financiare të studenteve. Në këtë thirrje inkurajohen që të aplikojnë vajzat/gratë nga komunitetet jo-shumicë dhe ato që vijnë nga zonat rurale.

## **PROCESI I APLIKIMIT**

Për të aplikuar, kandidatet duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

1. Letrën e motivimit (deri në 500 fjalë, në gjuhën shqipe);
2. Jetëshkrimin (CV-në);
3. Diplomën e shkollës së mesme dhe certifikatat e notave;
4. Dëshminë e pranimit në një nga programet STEM të universitetit përkatës;

Luteni që aplikimin ta dorëzoni përmes postës elektronike në adresën: [bursat.mashti@rks-gov.net](mailto:bursat.mashti@rks-gov.net) më së largu deri me datë 20/09/2021, në ora 16:00.

## **Aplikacionet e pakompletuara refuzohen në fazën e parë të vlerësimit teknik.**

Pas përmbylljes së procesit të përzgjedhjes, të përzgjedhurat do të nënshkruajnë deklaratën e zotimit të përmbushjes së kushteve dhe obligimeve, si dhe kontratën e mbështetjes financiare.

Arbërie Nagani

Ministër e MASHTI



**ANEKS LISTA E PROGRAMEVE STEM**

<b>Programet STEM</b>			
<b>Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"</b>			
<b>Drejtimit</b>			
<b>Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë</b>			
Nr.	Programi	Kampusi	Niveli i studimeve
1	Prodhimi Shtazor	Prishtinë	BSc
2	Prodhim Bimor	Prishtinë	BSc
3	Teknologji Ushqimore me Bioteknologji	Prishtinë	BSc
<b>Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit</b>			
Nr.	Programi	Kampusi	Niveli i studimeve
4	Inxhinieria e mjedisit	Prishtinë	BSc
5	Konstruktiv	Prishtinë	Bsc
6	Hidroteknik	Prishtinë	BSc
7	Gjeodezi	Prishtinë	BSc
<b>Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike</b>			
Nr.	Programi	Kampusi	Niveli i studimeve
8	Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë	Prishtinë	BSc
9	Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit	Prishtinë	BSc
10	Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike	Prishtinë	BSc
<b>Fakulteti i Matematikës dhe Shkencave të Natyrës</b>			
Nr.	Programi	Kampusi	Niveli i studimeve
11	Biologji	Prishtinë	BSc
12	Kimi	Prishtinë	BSc
13	Kimi Inxhinierike	Prishtinë	BSc
14	Shkencë Kompjuterike	Prishtinë	BSc
15	Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit	Prishtinë	BSc
16	Gjeografi	Prishtinë	BSc
17	Fizikë	Prishtinë	BSc
18	Matematikë	Prishtinë	BSc
<b>Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike</b>			

Nr.	Programi	Kampusi	Niveli i studimeve
19	Mekatronikë	Prishtinë	BSc
20	Termoenergjetika dhe Energjia e Ripërtërishme	Prishtinë	BSc
21	Dizajn Inxhinierik dhe Automjete	Prishtinë	Bsc
<b>Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"</b>			
Nr.	Programi	Kampusi	Niveli i studimeve
22	Teknologji	Mitrovicë	Bsc
23	Inxhinieri dhe tekonologji ushqimore	Mitrovicë	Bsc
24	Xehtari	Mitrovicë	Bsc
25	Gjeologji	Mitrovicë	Bsc
26	Materiale dhe Metalurgji	Mitrovicë	Bsc
27	Inxhinieri Ekonomike	Mitrovicë	Bsc
28	Makineri Prodhuese	Mitrovicë	Bsc
29	Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri	Mitrovicë	BSc
<b>Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka"</b>			
Nr.	Programi	Kampusi	Niveli i studimeve
30	Agromjedis dhe Agroekologji	Pejë	BSc
31	Teknologji Ushqimore	Pejë	BSc
32	Teknologji e Prodhimit Bimor	Pejë	BSc
<b>Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"</b>			
Nr.	Programi	Kampusi	Niveli i studimeve
33	Dizajn Softueri	Prizren	BSc
34	Teknologji Informacioni dhe Telekomunikimi	Prizren	BSc
35	Teknologji Informacioni dhe Telekomunikimi - Boshnjakisht	Prizren	BSc
36	Teknologji Informacioni dhe Telekomunikimi - Turqisht	Prizren	BSc
37	Shkencat e Pyjeve dhe të Mjedisit	Prizren	BSc
38	Agrobiznes	Prizren	BSc
<b>Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka"</b>			
Nr.	Programi	Kampusi	Niveli i studimeve
39	Shkenca Kompjuterike	Gjilan	BSc

**Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Ferizaj**

Nr.	Programi	Kampusi	Niveli i studimeve
40	Inxhinieria Industriale me Informatikë	Ferizaj	BSc
41	Informatika e Aplikuar	Ferizaj	BSc